

26109
08.11.16

REPubLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
KORÇE

Nr. (444)-00377 Regj. Them
Data e Regj: 23.03.2016

Nr.(459)-1177 Vendimi
Data:14.10.2016

V E N D I M

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korçe e perbere nga:

SOKOL IBI - Gjyqtar

Asistuar prej sekretares Viola Palla, pasi shqyrtoi ne seance gjyqesore publike, sot me date 14.10.2016, çeshtjen administrative me Nr.(444)-00377 Regj.Them, qe i perket paleve ndergjyqese:

PADITES: **Idelina Beqari**, e bija e Hiqmet, me dtl 1974, lindur dhe banuese ne Pogradec, lagja Nr.1, Rruga "Sh.Koroveshi", e perfaqesuar ne gjykim me deklarim ne seance nga shtetasi Lorel Beqari.

I PADITUR: **Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe**, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Mirela Veriga (ne mungese).

OBJEKTI: Shfuqizimin e aktit administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore date 01.12.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe me vlere 50.000 lek gjobe.

BAZA LIGJORE: Nenet 115 dhe 118 te K.Pr.Administrative, ligji Nr.7928, date 24.04.1995 i ndryshuar, ligji Nr.9920/2008, udhezimi Nr.24, date 02.09.2008.

Ne perfundim te gjykimit, gjykata pasi shqyrtoi provat ne teresi, degjoi konkluzionet perfundimtare te pales paditese e cila perfundimisht kerkoj pranimin

e padise, pala e paditur perfundimisht kerkoi rrezimin e padise,

VEREN

Se paditesja eshte person fizik tregetar e cila e ushtron aktivitetin e saj tregetar ne qytetin e Pogradecit.

Paditesja e ushtron aktivitetin e saj tregetar e papajisur me kase fiskale duke disponuar deftesa tatimore.

Me pare se ky biznes te regjistrohej ne emrin e paditeses ka qene i regjistruar ne emrin e bashkeshortit te saj ne QKR, dhe kishte edhe kase fiskale te regjistruar ne emrin e bashkeshortit te paditeses.

Ne kushtet kur paditesja e regjistroi biznesin ne emrin e saj ne QKR nuk e ndryshoi dhe kasen fiskale apo te ndryshonte emrin e bashkeshortit dhe te vendoste emrin e saj duke paraqitur nje kerkese ne organin tatimor.

Ne daten 04.08.2015 ne ambjentet ku ushtronte aktivitetin e saj tregetar jane paraqitur inspektoret e pales se paditur per te ushtruar kontroll ne baze te urdherit e punes Nr.23300, date 03.08.2015.

Inspektoret e pales se paditur kane konstatuar faktin qe paditesja e ushtronte aktivitetin e saj tregetar e papajisur me kase fiskale por vetem duke pasur deftesa tatimore. Kane konstatuar faktin se paditesja dispononte kase fiskale por qe ajo ishte e regjistruar jo ne emrin e saj.

Inspektoret e pales se paditur kane hartuar procesverbalin e konstatimit e kundravajtjes administrative te dates 04.08.2015 si dhe ne daten 03.11.2015 kane hartuar procesverbalin e gjobes ku kane vendosur denimin me gjobe te pales paditese ne masen e 50.000 lekeve per kryerjen e kundravajtjes administrative te parashikuar ne nenin 122, pika 1, germa a/i te ligjit Nr.9920/2008 te ndryshuar, per shkak se ushtron aktivitetin e saj tregetar e papajisur me kase fiskale.

Me njoftim vleresimin per detyrimet tatimore te dates 01.12.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korce njoftohet pala paditese per detyrimin e saj per te paguar gjoben ne masen e 50.000 lekeve.

Pala paditese i eshte drejtuar me kerkese ankimore Drejtorise se Apelimit Tatimor.

Drejtoria e Apelimit Tatimor me vendimin Nr.42257/1 Prot, date 22.02.2016 ka vendosur lenien ne fuqi te aktit administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore te dates 01.12.2015.

Ne te tilla rrethana pala paditese i eshte drejtuar me padine objekt gjykimi kesaj gjykate.

Pala paditese pretendon se gjoba i eshte vendosur ne menyre te kundraligjshme nga pala e paditur pasi aktivitetin e saj tregetar e ushtron e pajisur me deftesa tatimore.

Vonesa ne ndryshimin e kases fiskale ka erdhur per shkak te çregjistrimit me vonese qe ka bere pala e paditur nga emri i bashkeshortit tim dhe regjistrimi i kases fiskale ne emrin tim.

Une kerkesen pales se paditur ia kam bere qe ne daten 12.12.2014, ndersa çregjistrimi i kases fiskale eshte bere ne daten 22.05.2015 per shkak te burokracive dhe te mungeses se Drejtorit te Drejtorise Rajonale Tatimore Korce.

Pala e paditur ka prapesuar duke pretenduar se paditesja ka ushtruar aktivitetin e saj tregetar e papajisur me kase fiskale dhe ne te tilla rrethana ajo ka kryer kundravajtjen administrative te parashikuar nga neni 122, pika a/i te ligjit Nr.9920/2008.

Paditesja menjehere pasi e regjistroi aktivitetin tregetar ne emrin e saj duhet te instalonte kase fiskale dhe nuk mund te tregetonte duke perdorur deftesa tatimore.

Padia e paditeses eshte e pabazuar ne prova dhe ne ligj dhe duhet rrezuar nga gjykata.

Ne nenin 122 te ligjit Nr.9920/2008 "Per Procedurat tatimore" parashikohet: *"Tatimpaguesi person fizik ose juridik denohet ne rast se: a) nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme e monitorimit te qarkullimit: i) heren e pare te konstatimit te mosinstalimit te pajisjes fiskale ose sistemeve te monitorimit te qarkullimit, me gjobe ne masen 50.000 (pesedhjete mije) leke"*.

Gjykata vlereson se pretendimet dhe kerkimet e pales paditese ne padi jane te pabazuar ne prova dhe ne ligj.

Pretendimi i pales paditese se aktivitetin tregetar e ushtronte e pajisur me deftesa tatimore dhe per kete arsye nuk e ka kryer kete kundravajtje administrative eshte nje pretendim i pabazuar ne ligj.

Kundravajtja administrative quhet e kryer qe ne momentin qe pala paditese e ushtron aktivitetin e saj tregetar e papajisur me kase fiskale.

Paditesja kishte detyrimin qe menjehere pas regjistrimit te biznesit ne emrin e saj te kerkonte prane organit tatimor pajisjen me kase fiskale dhe jo te ushtronte aktivitetin e saj tregetar e papajisur me kase fiskale.

Paditesja rezulton se eshte regjistruar ne QKR si person fizik tregetar ne daten 12.12.2014 dhe qe prej kesaj date e deri ne ushtrimin e kontrollit nga ana e inspektoreve te pales se paditur data 04.08.2015 ka kaluar nje kohe e gjate qe paditesja e ushtronte kete aktivitet tregetar e papajisur me kase fiskale.

Pretendimi i pales paditese se ka bere kerkese prane organit tatimor per te ndryshuar emrin e kases fiskale nga emri i bashkeshortit e saj ne emrin e saj dhe se kane qene burokracite e pales se paditur qe nuk kane bere ndryshimin e ketij emri, jane pretendime te pabazuara ne prova dhe nuk justifikojne ushtrimin e aktivitetit tregetar e papajisur me kase fiskale.

Per keto arsye akti administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore eshte nje akt administrativ i ligjshem dhe i vlefshem dhe per keto arsye padia e paditesit duhet rrezuar nga gjykata si e pabazuar ne prova dhe ne ligj.

Ne baze te nenit 45 te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012 "Per Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative", ndaj ketij vendimi nuk lejohet ankim, sepse objekt kerkimi eshte kundershimi i akteve administrative qe permbajne detyrime ne te holla me vlere me te vogel se njezetefishi i pages minimale ne shkalle vendi. Paga minimale ne shkalle vendi me baze te V.K.M Nr.573, date 03.07.2013 eshte ne masen 22.000 leke, ndersa njezetefishi i saj eshte i barabarte me 440.000 leke.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te neneve 40, 41, 45 te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012 "Per Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative"

VENDOSI

1. Rrezimin e padise si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Shpenzimet gjyqesore jane ne ngarkim te pales paditese.
 - Kunder ketij vendimi nuk lejohet ankim.
 - Nje kopje e ketij vendimi ti komunikohet pales se paditur ne mungese.
 - U shpall sot me date 14.10.2016 ne Korçe.

SEKRETARE

VIOLA PALLA

GJYQATAR

SOKOL IBI

Shpenzimet gjyqesore:

1. Takse pulle 3.000 leke;
Totali 3.000 leke (te parapaguara nga paditesi).